



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 810/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.11.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “OES Distrimed” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-83985-08-28-2018, Loti 3, me objekt: “Hemokultura”, me fond limit 3.094.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 24.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

Ankimues:

“Biochem NRP” sh.p.k.

Adresa: Rruga “Shkëlqim Fusha”, Pallati AIKonstruksion, Kati 1, Zona Kadastrale 3292, Numër Pasurie 102/14-N5, Farkë, Selitë, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

Adresa: Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.08.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-83985-08-28-2018, Loti 3, me objekt: “Hemokultura”, me fond limit 3.094.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 24.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

II.2. Në datën 24.09.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 04.10.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Euromed” shpk

Pa ofertë

skualifikuar

2. “O.E.S Distrimed” shpk	2,772,000 lekë	kualifikuar
3. “Biochem NRP” shpk	3,074,000 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 04.10.2018, operatori ekonomik “Biochem NRP” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi:

II.4.1. Në datën 09.10.2018, operatori ekonomik “Biochem NRP” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” shpk në këtë procedurë prokurimit si mëposhtë:

“[...] Ne DST, Loti 3 “Hemokultura” me REF-83985-08~28-2018, ne kriteret e veçanta te kualifikimit eshte kerkuar:

e) Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autodeklaraten per konformitetin me normen MDD 93/42/EEC ose 98/79/EC te materialeve mjekesore, kite, reagente, konsumable, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatese, CE/DC (Deklarate Komformiteti) kur eshte e aplikueshme sipas Direktivave dhe klasifikimit te Keshillit te Europes, te prodhuesit, origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara te vlefshme ne momentin e hapjes dhe dorezimit te ofertave.

Nga kalsifikimi perfundimtar konstatuam se KVO gjate vleresimit Loti:3 Hemokulturaka renditur te pari, OE “O.E.S Distrimed” shpk. Ky operator ekonomik perfaqesohet me Mindray prodhues Kinez vetem per hematologji, biokimi dhe hemostazen (link ẽebbsite <http://ẽẽẽ.mindray.com/en/categorvlln-VitToDiagnostics.html> dhe <http://www.mindray.com/en/GroupMember.html>), ndersa per hemokulturen perfaqesohet nga prodhuesi “TDR Bio-Tech”. Gjetur kjo ne website te Mindray (dokumenti 1). Ne asnje dokument te ketij prodhuesi nuk gjendet Deklarata e Komformitetit me normen 93/42/EEC ose 98/79/EC te materialeve mjekesore, kite, reagente.

Te gjithë prodhuesit Kinez duke filluar nga “Zhuhai DL Biotech Co.,Ltd” (dokumenti 2) qe klasifikohet si prodhuesi kryesor ne Kine nuk permbushin Direktivat dhe klasifikimin e Keshillit te Europes, ne keto kushte per ne eshte shume e dyshimte CE/DC (Deklarate Komformiteti) me normen MDD 93/42/EEC ose 98/79/EC te materialeve mjekesore, kite, reagente, konsumable. (te prodhuesit per cdo artikull te ofertuar) bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatese.

Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonornike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates.

Ne nenin 46, pika 1, te ligjit m.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht se: "Operoret ekonomike, per te marre pjese ne procedural e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese"

Ne nenin 53/3 te LPP-se percakohet se: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje o.ferte te vle.fshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit".

Operoret ekonornike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme. Pranimi, shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave duhet te behet ne zbatim te dokumenteve te tenderit, pasi ne rast te kundert do te cenonte parimin e barazise ne procedurat e prokurimit. Zbatimi i parimit te transparences barazise, dhe mosdiskriminimit jane garancite kyce ndaj ofertuesve qe ofron kuadri ligjor ne fuqi.

Per sa me siper, kerkojme:

- Anullimin e vendimit tuaj per kualifikimin e ofertes se paraqitur nga shoqeria "O.E.S Distrimed" shpk pasi nuk ploteson specifikimet teknike dhe kriteret per kualifikim.
- Kualifikimin e ofertes sone si oferte fituese pasi eshte e vetmja oferte qe ploteson specifikimet teknike te kerkuara, pra oferte qe ploteson kriteret dhe specifikimet teknike.

II.4.2. Në datën 18.10.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 4421/4 prot, i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur refuzimin e ankesës.

II.4.3. Në datën 26.10.2018 operatori ekonomik "Biochem NRP" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesë të paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Me shkresën me nr. 4421/7 prot, datë 07.11.2018, protokolluar me tonën me nr. 1646/2 prot, datë 09.11.2018, me objekt "Informacion mbi procedurën e prokurimit dhe ankesës së operatorit ekonomik ankimues Biochem NRP sh.p.k", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik "O.E.S Distrimed" sh.p.k. se: "Nga kalsifikimi perfundimtar konstatuam se KVO gjate vleresimit Loti:3 Hemokulturaka renditur te pari, OE "O.E.S Distrimed"

shpk. Ky operator ekonomik perfaqesohet me Mindray prodhues Kinez vetem per hematologji, biokimi dhe hemostazen (link  esbsite <http://   .mindray.com/en/categorvlln-VitToDiagnostics.html> dhe <http://www.mindray.com/en/GroupMember.html>), ndersa per hemokulturen perfaqesohet nga prodhuesi “TDR Bio-Tech”. Gjetur kjo ne  esbsite te Mindray (dokumenti 1). Ne asnje dokument te ketij prodhuesi nuk gjendet Deklarata e Komformitetit me normen 93/42/EEC ose 98/79/EC te materialeve mjekesore, kite, reagente. Te gjitha prodhuesit Kinez duke filluar nga “Zhuhai DL Biotech Co.,Ltd” (dokumenti 2) qe klasifikohet si prodhuesi kryesor ne Kine nuk permbushin Direktivat dhe klasifikimin e Keshillit te Europes, ne keto kushte per ne eshte shume e dyshimte CE/DC (Deklarate Komformiteti) me normen MDD 93/42/EEC ose 98/79/EC te materialeve mjekesore, kite, reagente, konsumable. (te prodhuesit per cdo artikull te ofertuar) bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatese.”, Komisioni i Prokurimit Publik v eren se:

III.1.1. N  shtojc n 9, Loti III “Kriteret e vecanta t  kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.e, t  dokumentave standarte t  tenderit t  procedur s s  prokurimit objekt ankimimi, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor  sht  parashikuar si m  posht  vijon:

e) Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autodeklaraten per konformitetin me norm n MDD 93/42/EEC ose 98/79/EC te materialeve mjekesore, kite, reagente, konsumable, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatese, CE/DC (Deklarate Komformiteti) kur eshte e aplikueshme sipas Direktivave dhe klasifikimit te Keshillit te Europes, te prodhuesit, origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara te vlefshme ne momentin e hapjes dhe dorezimit te ofertave.

III.1.2. Nd rsa n  shtojc n 10, “Specifikimet teknike”, n  dokumentat e tenderit t  procedur s s  prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka p rcaktuar:

Loti 3 Hemokultura

Nr	Emertimi	Njesia
1	Shishe hemokulture aerobike per te rritur	Shishe
2	Shishe hemokulture aerobike per femije	Shishe
3	Shishe hemokulture anaerobike per te rritur	Shishe
4	Shishe hemokulture anaerobike per femije	Shishe

Specifikime teknike per Shishet e hemokultures (~)

- Cdo artikull duhet te kete skadencen 1/2 e kohes ndermjet dates se prodhimit dhe asaj te skadences ne ditën e levrimit te mallit.
- Materialet mjekesore, reagentet, kitet, konsumablet duhet te jene te certifikuar CE konform normes MDD 98/79/EC ose 93/42/EEC (kur eshte e aplikueshme sipas direktivave dhe klasifikimit te Keshillit European).
- Shishet duhet te jene ne perberje te terrenit rezina apo ingrediente qe neutralizojne antibiotiket
- Shishet duhet te jene te pathyeshme

- *Teknologjia e perdorur per detektimin e mikroorganizmave te pranishme ne gjak “Colorometric detection”.*

Firma fituese duhet te sjelli edhe aparatit e leximit automatik.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k., në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se për vërtetimin e përmbushjes së kriterit të mësipërcituar është paraqitur nga ky operator ekonomik dokumentacioni si mëposhtë:

1. *Autodeklaratë mbi Konformitetin nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k, se mallrat e ofruara janë konformë me normën MDD 93/42/EEC ose 98/79 EC ose të materialeve mjeksore.*
2. *Autorizim prodhuesi, date 19 Shtator 2018 nga “Hunan Changsha Tiandiren Biotech Co., LTD”;*
3. *Statement te dates 13 mars 2013, nga Shenzhen Mindray Bio-Medical Electronics Co., Ltd, ku deklarohet se 51 % e aksioneve te “Hunan Changsha Tiandiren Biotech Co., LTD” eshte ne pronesi te kesaj te fundit., si dhe autorizim si shites dhe distributor per produktet e sistemit te analizave bakteriale nen rnrarken tregtare “Mindray” te Shenzhen Mindray Bio-Medical Electronics Co., Ltd.*
4. *Deklarate konformiteti CE, prodhues: “Hunan Changsha Tiandiren Biotech Co., LTD”, perfaqesues CE: Shanghai International Holding Corp. GmbH (Europe), EiffestraBe 80 20537 Hamburg, Gjermani, produkti: Sisteme Hemokulture te Automatizuar, ku deklarohet se produktet (TDR-X060) permbushin provizionet e Direktives 98/79/EC ne pajisjet mjekesore te Diagnostikimit in-Vitro.*
5. *Deklarate konformiteti CE, prodhues: “Hunan Changsha Tiandiren Biotech Co., LTD”, perfaqesues CE: Shanghai International Holding Corp. GmbH (Europe), EiffestraBe 80 20537 Hamburg, Gjermani, produkti: Shishe Kulture Anaerobike, ku deklarohet se produktet permbushin provizionet e Direktives 98/79/EC ne pajisjet mjekesore te Diagnostikimit in-Vitro.*
6. *Deklarate konformiteti CE, prodhues: “Hunan Changsha Tiandiren Biotech Co., LTD”, perfaqesues CE: Shanghai International Holding Corp. GmbH (Europe), EiffestraBe 80 20537 Hamburg, Gjermani, produkti: Shishe hemokulture Aerobike, ku deklarohet se produktet permbushin provizionet e Direktives 98/79/EC ne pajisjet mjekesore te Diagnostikimit in-Vitro.*
7. *Certifikate e Menaxhimit te Cilesise sipas standardeve YYIT 0287-2017 idt ISO 13485 : 2015 (e vlefshme deri me 05/03/2021), ne emer te Hunan Changsha Tiandiren Bio-Tech Co., Ltd., leshuar nga Beijing Hua Guang Certification of Medical Devices CO., LTD (certifikate CMD).*
8. *Certifikate e Menaxhimit te Cilesise sipas standardeve GBIT 19001-2016 idt ISO 9001:2015 (e vlefshme deri me 05/03/2021), ne emer te Hunan Changsha Tiandiren Bio-Tech Co., Ltd., leshuar nga Beijing Hua Guang Certification of Medical Devices CO., LTD (certifikate CMD).*

III.1.4. Në nenin 46, pika 2, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: 2. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]*”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”.

III.1.5. Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet 2. *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

III.1.6. Në nenin 30 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se”

1. “*Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*”

2. “*Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*”

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përplotësim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në mënyrë elektronike nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” shpk, në përmbushje

të kriterit të sipërcituar, si dhe bazuar në argumentat e autoritetit kontraktor në kthim përgjigjen e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, pasi bëri verifikimin në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), në lidhje me dokumentacionin që operatori ekonomik ankimues “Biochem NRP” shpk ngre pretendime, konstaton se Deklaratat e Konformitetit CE të paraqitura nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” shpk janë të vlefshme dhe konformë Direktivës 98/79/EC, dhe se certifikatat e përpuethshmërisë së konformitetit CE të produkteve të kërkuara janë në përputhje me kërkesat e direktivës 98/79/EC kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Sa më sipër rezulton se operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” shpk ka aritur të provojë se për mallrat e sipërcituar objektë prokurimi ka paraqitur Deklaratat e Konformitetit CE, konformë Direktivës 98/79/EC. Për këtë arsye, Komisioni e konsideron të përmbushur kërkesën e sipërcituar të autoritetit kontraktor.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” sh.p.k në këtë procedurë prokurimi, për përmbushjen e kriterit të sa mësipërcitura do të konsiderohet i vlefshëm, duke e përmbushur kriterin e parashikuar në shtojcën 9 Loti III “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.(e)., me sukses.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranoj ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Biochem NRP” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-83985-08-28-2018, Loti 3, me objekt: “Hemokultura”, me fond limit 3.094.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 24.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1646 Protokoli, Datë 26.10.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NënKryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha